



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 24.02.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 22.02.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Arber Rexha BI" për aktivitetin: "Sherbime të veçanta kontraktuese për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-260-211** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Arber Rexha BI" e datës 22.02.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sherbime të veçanta kontraktuese për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-260-211** kundër *Njoftimit për Kontrate të AK-se të datës 03.02.2021*, të publikuar në Platformën E Prokurimi.

1. **Vërtetohet** *Njoftimi për kontrate i Autoritetit Kontraktues të datës 03.02.2021 dhe AK-ja vazhdon aktivitetin sipas të njëjtit;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Arber Rexha BI" me datë 22.02.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sherbime të veçanta kontraktuese për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-260-211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 24.02.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj është se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kriter përjashtues në pikën 9.1. Lidhur me këtë ju sqarojme si vijon:

Komuna e Prishtinës në vitin 2020, ka pas me shumë se dy mijë lende të reja në Gjykate, andaj kriteri i vendosur për shoqëri të avokateve buron nga ky fakt, sepse Komuna kërkon shoqëri të avokateve për të perballuar volumin e lendeve dhe natyrën e ndryshme të tyre, andaj nuk mundet një ceshtje kaq e ndjeshme t'i ipet avokateve individual për ta perfaqësuar Komunen me të madhe në vend. Po ashtu

kriteri per shoqeri te avokateve eshte kategori ligjore dhe nuk eshte e shpikur nga ne (shih: LIGJI Nr. 04/L-193 PËR AVOKATINË neni 30).

Sa l perket pretendimit se ne regjistrin e Odes se Avokateve, vetem nje OE, e ploteson nje kusht te tille, ju bejme me dije se kjo nuk qendron sepse ne regjistrin e Odes se Avokateve, shoqeri te avokateve jane :

1. "Ramajli & Partners"
2. "SCLR"
3. "Sejdiu & Qerkini"
4. "Nikqi & Associates" LLC
5. "ISC Assistance" LLC
6. "Avokatura Istrefi" shpk
7. "Koci & Vokshi" shpk
8. "Havolli & Partners" shpk
9. "Vokshi & Lata" shpk
10. "Klinaku Associates" shpk
11. "Kerveshi & Partners Law Firm shpk
12. "RPHS" shpk

Ne lidhje me kete ceshtje ju sqarojm se neve nuk kemi kerkuar qe themelues te jene 3 avokat, mirepo kemi kerkuar qe shoqeria t'i kete se paku 3 avokate, konform nenit 30, paragrafi 4, te LIGJIT Nr. 04/L-193 PËR AVOKATINË.

Ky eshte kriter teknik profesional, l parapare ne LIGJIN Nr. 04/L-193 PËR AVOKATINË dhe nuk ka te beje me diskriminim. (p.sh. AK mund te kerkoj si kriter edhe gendjen ekonomike financiare e cila mund te kerkohet deri ne dyfishin e vleres se parashikuar te kontrates, qe l bie 1.200.000.00€, per te cilin shumica e avokateve individual nuk do ta kishin plotesuar mirepo ky nuk eshte diskriminim)

Po ashtu ne sqarimet qe l kemi dhene me pare, eshte theksuar se te njejtit mund te aplikojne si Grup l OE-se, ne kozorcium me shoqerite e avokateve ne menyre qe ta plotesojn kete kriter.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

